



V E N D I M
Nr. 48 Date 18.04. 2008
PER
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (PARKU EOLIK “PROJEKTI
KAPPET” SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9, dhe 39, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, nenit 9, pika 1 dhe pika 2, germa a, te “Rregullave dhe Procedurave te Certifikimit te Prodhimit te Energjise Elektrike nga Burimet e Rinovueshme” te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, date 21.02.2007 ; nenit 18, pika 1, germa e, te Rregullave te Praktikes dhe Procedurave te ERE-s”, miratuar me Vendimin nr.44, date 24/07/2007, dhe Vendimit te Bordit te Komisionereve nr. 33 date 21.03.2008 “Per fillimin e procedurave per kualifikimin e impiantit prodhues Parku Eolik “Projekti Kappet”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.04.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria HERA sh.p.k, per kualifikimin e impiantit prodhues Parku eolik, “Projekti Kappet”, si burim i rinovueshem energjie dhe konstatoi rregullshmerine e aplikimit,

Vendosi

1. Kualifikimin e impiantit prodhues Parku eolik, “Projekti Kappet” si burim i rinovueshem energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftojne aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta